

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>	

KOSTT

Raport për tremujorin e dytë 2011

(01.04.2011-30.06.2011)

	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Shpresa Kursani	Fadil Ismajli KSHE	Kryesuesi i BD Ramadan Paçarada
Nënshkrimi			
Data	<i>Korrik, 2011</i>		

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Raport Tremujor për Bordin e Drejtorëve në KOSTT
Periudha Prill - Qershor 2011

1	Titulli i Dokumentit	Raport Tremujor 2011
2	Dërguesi i dokumentit	Fadil Ismajli, Kryeshef Ekzekutiv
3	Përmbajtja e Raportit	<p>Kapitulli 1: Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet që janë bërë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011</p> <p>Kapitulli 2: Shqyrtim i performancës afariste dhe financiare</p> <p>2.1. Raport i realizimit të Indikatorëve Kyç të Performancës – operimi i sistemit dhe operimi i transmisionit</p> <p>2.2. Raport i operimit të tregut</p> <p>2.3. Statusi i investimeve (projekteve) kapitale në KOSTT</p> <p>2.4. Çështjet Rregullative</p> <p>2.5. Shqyrtimi i performancës financiare</p> <p>2.5.1. Pasqyrat financiare (Balanci i Gjendjes dhe Pasqyra e Fitimit/Humbjes, Realizimi i projekteve kapitale nga BK gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011)</p> <p>2.5.2. Analiza e IKP-ve financiare</p> <p>Kapitulli 3 : Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore</p> <p>Kapitulli 4: Kontratat/Transaksionet e konsiderueshme gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011 nga burimet e KOSTT</p> <p>Shtojcë 1: Raporti për funksionimin e qeverisjes korporative</p>
4	Data e Raportimit	

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Hyrje

Raporti i tremujorit Prill- Qershor 2011 është përpiluar bazuar në dispozitën e nenit 31.1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ku brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport për tremujorin e sapo përfunduar (“tremujori përkatës”) i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Pas aprovimit të këtij Raporti nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, ky Raport do të dërgohet te Njësia për Politikën dhe Monitorimin të NP-ve.

Raporti paraqet rezultate kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë tremujorit të dytë të këtij viti si dhe të aktiviteteve krahasuar me planin vjetor dhe shkallën e realizimit.

Në kapitujt e këtij Raporti, paraqiten të dhënat kryesore për strukturën organizative dhe ndryshimet e bëra, shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare, e shprehur edhe me Indikatorët Kyç të Performancës (IKP) teknike dhe financiare, të dhënat rreth operimit të tregut, projektet aktive në KOSTT të paraqitura sipas vlerës, afateve dhe statusit të tyre, procedurat gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruar, transaksionet e konsiderueshme të tremujorit të dytë, për të përfunduar me Shtojcën, e cila paraqet funksionimin e qeverisjes korporative të KOSTT-it.

Përbërja e Raportit është identike me përbërjen e definuar në nenin 31.1 të Ligjit Nr. 03/L-087.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë tremujorit të dytë 2011

1.1. Organizimi

Struktura organizative e KOSTT-it e përbërë nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti. KOSTT është përcaktuar të ketë një afarizëm të pavarur dhe si i tillë reflekton një fushëveprim bilateral të afarizmit.

Organizimi i KOSTT është bazuar në afarizmin themelor tekniko-operativ, ku mbulohet me Departamentet:

- Operatori i Sistemit
- Operatori i Transmisionit
- Operatori i Tregut

Afarizmi tjetër ka karakter projektues, komercial, rregullativ, ligjor, marrëdhënieve me punëtorë, administrativ, zhvillimit të personelit, teknologjisë së informacionit dhe zhvillohet përmes Departamenteve mbështetëse:

- Inxhinieringu dhe Menaxhimi i Projekteve
- Çështjet Ligjore dhe Rregullative
- Financat
- Burimet Njerëzore dhe
- Prokurimit

Në Drejtorinë Qendrore të KOSTT-it janë edhe tri njësi, të emëruara si Zyre, të cilat kanë karakter mbështetës në aspektin e obligimeve financiare, ligjore dhe organizative, që janë:

- Zyra për Zhvillim dhe Planifikim Afatgjatë
- Zyra për Komunikim dhe Relacione me Publikun dhe
- Zyra për Siguri Industriale dhe Mjedis

1.2. Numri i Punëtorëve

Me datën 01 Prill 2011 numri i i përgjithshëm i të punësuarve në KOSTT ishte 234, ndërsa më 30 qershor ky numër arrit në 244.

Arsye e rritjes të numrit të punëtorëve është:

- 10 (dhjetë) teknik-praktikantë me PMP kanë filluar punën gjatë muajit Prill dhe Maj 2011.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Nga numri i përgjithshëm i punëtorëve (244), prej tyre:

- 2 punëtorë gjenden në pushim pa pagesë dhe
- 1 (një) punëtorë gjendet në pushim të lehonisë

Në vazhdim është dhënë Organogrami – Makro Struktura organizative e KOSTT-it, e aprovuar më 30 mars 2011.



RAPORT TREMUJOR


ver. 1.0

DT-PB-002

faqe 6 nga 46

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti



	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 7 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare


2.1. Raport për operimin e sistemit dhe transmisionit për Indikatorët Teknik të Performancës

2.1.1. Balanca e planifikuar dhe e realizuar prill- qershor 2011


Muajt (MWh)	Prill-Qershor 2011		
	E planifikuar	E realizuar	real/plan. %
(1) TC Kosova A	345 690	424 960	122,93
(2) TC Kosova B	755 568	758 956	100,45
(3) HC Ujmani	22 000	28 206	128,21
(4) Lumbardhi	13 511	11 418	84,51
5=1+2+3 Total Prodhimi	1 123 258	1 212 123	107,91
(6) Devijimi	0	16 080	
(7) Eksporti	0	137 757	
(8) Importi	167 862	137 930	82,17
9=5-6+8-7 Energjia në disponim	1 291 120	1 196 216	92,65
(10) Distribucioni	1 028 742	913 399	88,79
(11) Ferronikeli	169 105	137 333	81,21
(12) Trepça	5 900	5 426	91,96
(13) Sharri	18 900	19 240	101,80
(14) Mihjet, Kos.thëngj, NS Palaj, gjenerim konsum.e jasht.KEK, LP 290	30 100	96 871	0,00
15=10+11+12+13+14 Konsumi neto	1 252 747	1 172 268	93,58
(16) Humbjet në transmision	38 734	23 947	61,82
17=15+16 Konsumi bruto	1 291 481	1 196 215	92,62
Ngarkesa maksimale MW	850	875	102,94

Të dhënat e planifikuara janë marrë nga dokumenti Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2011, ndërsa të dhënat e realizuara nga pikat matëse dhe të transferuara në kufi të Kosovës.


Balanca e planifikuar Prill-Qershor 2011



Balanca e realizuar Prill-Qershor 2011



Diagrami i bilancit të realizuar elektroenergjetik Prill-Qershor 2011 (GWh)



	RAPORT TREFUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 10 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.1.2. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit

Nr	Indikatori		2010	2011	2011/2010(%)	Caku	Komenti
			Prill-Qershor 2010	Prill-Qershor 2011			
T1	Energjia e transmetuar (GWh)		1937,83	1916,43	98,90	Nuk mund të vendoset sepse nuk mund të parashihet transiti, e me këtë as hyrjet totale në transmision	Caku nuk vendoset për këtë IKP,
T2	Piku koincident (MW)		864	875	101,27	Caku: 1060MW (Sipas: Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2011).	Caku nuk vendoset për këtë IKP, por shihet që piku është më i lartë në periudhën Prill-Qershor 2011 se sa Prill-Qershor 2010
T3	Gjatësia totale e linjave (km)	400 kV	181,815	181,815	100,00	= > 1	Caku mund të vendoset për çdo vit me ndërtimin e linjave të reja ose riparimin/rindërtimin e linjave të cilat aktualisht nuk janë në operim. Ky cak bazohet në Planin Zhvillimor të Transmisionit.
		220 kV	231,882	231,882	100,00		
		110 kV	672,1085	727,6	108,26		
T4	MVA-km	400 kV	239450	239450	100,00	= > 1	Caku është si në T3
		220 kV	77506	77506	100,00		
		110 kV	78279	80573	102,93		

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

T5	Kapaciteti i transformatorëve	400-220;400-110 kV	1500	1500	100,00	= > 1	Ky cak mund të vendoset për çdo vit për instalimin e transformatorëve të ri.
		220-110 kV	1050	1200	114,29		
T6	Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar Import/Eksport(AATC)						I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E
T7	Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal Import/Eksport MATC						I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E
T8	Pagesa për kongjestion						KOSTT do të filloj kur ATC do të alokohet nga OT/kontrollohet nga OS për TTC teknike.
T9	Koha mesatare e ndërprerjes (AIT minuta/vit)		80,02	44,55	55,68	Caku vendoset sipas raportit: (AIT për periudhen actuale)/(AIT për periudhen e kaluar) < 1	AIT (Koha mesatare e rënjes) 80,02 minuta gjatë tre muajve Prill-Qershor 2010, ndërsa 44,55 minuta për periudhen e njëjtë 2011
T10	Numri i ankesave për tension		2	1	50,00	Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1	Caku për ankesa për tension duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave në vitin (et) paraparak në periudhen e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet të jetë në kohë sa më të shkurtë. Gjatë kësaj periudhe, ka pasur një ankesë për tension, nga

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 12 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

							Sharri.
T11	Ankesat e zgjidhura për tension	Më pak se një javë	2	1	50,00	Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1	Caku për zgjidhjen e ankesave për tension duhet të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur (< 1 javë). Kjo nënkupton që përqindja më e lartë në kategorinë e parë, është më mirë.
		Më pak se një muaj				Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1	Caku për ankesa të matjeve duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave për vitin(et) paraprak(e).
		Më shumë se një muaj				Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1	
T12	Numri i ankesave për matje		0,00	0			
T13	Ankesat e zgjidhura për matje	Më pak se një javë	0,00	0		Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1	Caku për zgjidhjen e ankesave për matje duhet të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur (< 1 javë). Kjo nënkupton që përqindja më e lartë në kategorinë e parë, është më mirë.
		Më pak se një muaj				Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1	
		Më shumë se një muaj				Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1	
T14	Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/orë)	Import	15,78	20,48	129,81	20MWh/h tërheqje jashta programit të deklaruar	Stafi i Qendrës së Kontrollit ka për qëllim që devijimet mesatare absolute në orë të programeve të importeve/eksporteve të jenë sa më të vogla.
		Eksport	14,53	25,37	174,60	20MWh/h shtyerje jashta programit të deklaruar	

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 13 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

T15	Humbjet në transmision (GWh)		25,11	23,94	95,34		Humbjet e energjisë elektrike në transmision kanë qenë më të vogla në periudhën Prill-Qershor 2011 se sa në periudhën Prill-Qershor 2010
------------	------------------------------	--	--------------	--------------	--------------	--	--

$$AIT = (8760 * 60 * ENS) / TE$$

ENS-Energy not supplied - EPF-Energjia e pafurnizuar

TE-Transmitted energy - ET- Energjia e transmetuar

AIT- Average interruption time - KMR - Koha mesatare e rënieve

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 14 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.1.4. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit

Nr	Indikator	Niveli i tensionit	2010	2011	Krahasimi	Caku	Komenti
		kV	Prill-Qershor	Prill-Qershor	2011/2010 (%)	< = 1	
T1	Numri i prishjeve në linja në 100km gjatësi	400	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0.00	0.00	0		
		110	0.00	0.46	0		
T2	Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë(orë)	400	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0.00	0.00	0		
		110	0.00	10.07	0		
T3	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (minuta)	400	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0.00	0.00	0		
		110	0.00	0.00	0		
T4	Numri i prishjeve në transformator në 100 transformator(njësi)	400/220(110)	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220/110	0.00	0.10	0		
T5	Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformator(orë)	400/220(110)	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220/110	0.00	3.00	0		

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 15 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

T6	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (minuta)	400/220(110)	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220/110	0.00	0.00	0		
T7	Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha	400	0.00	0.00	0	> 1	Avaritë në TMRR në NS Prishtina 2
		220	0.00	0.00	0		
		110	1.20	5.26	438.3330		
T8	Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë)	400	0.00	0.00	0	> 1	Avaritë në TMRR në NS Prishtina 2, thyerje e ndarësi t në NS Theranda dhe defekt në ndërprerës në NS Prishtina 3.
		220	0.00	0.00	0		
		110	2.70	6.45	238.889		
T9	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit(fushës)(minuta)	400	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0.00	0.00	0		
		110	1.88	0.00	0		
T10	Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha	400	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	2.77	0.00	0		
		110	2.56	0.00	0		

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 16 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

T11	Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje rele/kontroll (orë)	400	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	2.00	0.00			
		110	3.25	0.00			
T12	Koha mesatare shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit (minuta)	400	0.00	0.00	0	< = 1	Performancë pozitive
		220	0.00	0.00			
		110	0.00	0.00			

	RAPORT TREGUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 17 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.2. Raport mbi operimin e tregut

2.2.1. Madhësia e Tregut

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral ku pjesa më e madhe e tregut është e rregulluar dhe mungon konkurrenca në tregun me shumicë dhe atë me pakicë. Ekziston vetëm një furnizues që furnizon konsumatorët e rregulluar dhe ata të pa rregulluar.

Të drejtën e konsumatorit të kualifikuar e shfrytëzon Feronikeli por meqenëse nuk ka furnizues tjerë përveç Furnizuesit Publik që operojnë në Kosovë Feronikeli furnizohet nga furnizuesi publik me çmim të rregulluar (jo tarifor). Për shkak të mungesës së konkurrencës dhe furnizuesve të tjerë dhe sipas ligjeve të reja lejohet që konsumatori i kualifikuar të furnizohet nga Furnizuesi Publik me çmim të rregulluar i cili ndryshon nga niveli i tensionit ku ata janë të kyçur. Është arritur marrëveshje midis KEK, Feronikelit dhe ZRRë që Feronikeli të furnizohet nga KEK. Furnizimi me çmim të rregulluar (jo tarifor) në nivelin 220kV. Prandaj madhësia e tregut që i referohet segmentit të pa-rregulluar do të paraqitet vetëm në këtë tremujor si raport i energjisë së konsumuar nga konsumatorët e privilegjuar (kualifikuar) në raport me konsumin e përgjithshëm në Kosovë. Kjo përfshinë energjinë e përgjithshme që ka dalë nga transmissioni dhe energjinë që ka hyrë në distribucion nga Lumbardhi, e cila gjithashtu është pjesë e konsumit.

Konsumi tarifor (pa Feronikelin) në nivel me pakicë në Prill-Qershor '11 ishte mesatarisht rreth 80.21% të konsumit të përgjithshëm bruto (duke mos përfshirë humbjet në transmissiion).

Në vijim është paraqitur figurativisht madhësia e tregut tarifor në raport me tregun e jo tarifor. Konsumi i KEK nga rrjeti i transmissiionit për nevoja vetjake, i cili është i veçantë nga tregu tarifor dhe ai jo-tarifor është i paraqitur gjithashtu në figurë

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 19 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Në çmimin mesatar të sistemit ndikon dukshëm sasia e importit dhe çmimi i tij. Si shihet nga tabela çmimi i importit të energjisë elektrike ka pasur rënie dhe si pasojë edhe çmimi i ponderuar i energjisë elektrike ka pasur rënie nga viti 2009 deri në vitin 2010, ndërsa në vitin 2011 kemi ngritje të çmimit mesatar të sistemit ku një nga arsyet është edhe ngritja e çmimit të importit për këtë tremujor.

Çmimet e rregulluara dhe të parregulluara energjisë elektrike

		2009 €/MWh	2010 €/MWh	2011 €/MWh
Çmimet e rregulluara	Kosova B	23.32	23.35	24.4
	Kosova A	23.32	23.35	24.4
	HC Ujmani	24	27.4	27.5
	HC Lumbardhi	40	40	40
Çmimet e parregulluara	Importi - çmimi mesatar	75,89	57,95	63.99
	Eksporti - çmimi mesatar	20,17	26,45	45.90
Çmimi mesatar i ponderuar i sistemit		25,78	24,15	28.57

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	ver. 1.0	faqe 20 nga 46
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

2.1. Statusi i investimeve (projekteve) kapitale në KOSTT

Projekti	Buxheti	Fincuar nga	Vlera e Kontrates	Data e fillimit	Data e kompletimit	Kontraktues	Realizimi Q2	Realizimi: (i.) Progresi, (ii.) rreziku dhe pengesat	Rekomandimet
1 <i>Projekti i Rehabilitimit të NS 220/110 kV – Kosova A</i>	10,334,070.00 €	BKK / Kfw	9,881,052.73 €	17.12.2007	16.12.2009	Siemens (At)	0.00 €	(i.) Projekti është nën fazën garantuese njëvjeçare, deri më 27.10.2011. Gjatë këtij kuartali kontraktuesi ka bërë progres në eliminimin e vërejtjeve të komisionit për pranim teknik intern, mirëpo ende mbeten disa vërejtje të cilat kontraktuesi duhet t'i eliminojë me Dokumentacionin sipas Realizimit (As Build) dhe të sjell librin ndërtimor.	Duhet të eliminohen vërejtjet e mbetura nga Komisioni për pranim teknik si dhe të plotësohet disajni "As Build Drawings"
2 <i>Paket Projekti i NS 400/110 kV – Peja 3 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 & 110 kV</i>	23.343.233,00 €	BKK / Kfw	21.562.716,00 € (pa taksa)	10.06.2008	15.03.2010	Siemens & Umel (B&H)	0.00 €	(i.) Nuk ka pograms në përmblylljen e liferimit të pajisjeve rezerve nga ana e kontraktorit, për NS Peja 3, prandaj edhe obligimet rreth pagesave nuk janë realizuar . (ii.)Sa i përket Punëve Opcionale në NS Skenderaj, janë zhvilluar aktivitete në drejtim të zgjidhjes së çështjes pronësoro juridike për ndërtimin e shtyllës nr.1, të linjës 110 kV, që furnizon NS 110/10(20) kV – Skenderaj .Stafi menaxhues i KOSTT ka mbajtur takimin me kryetarin e Komunës së Skenderaj dhe pronarin e tokës, i cili takim ka rezultuar pozitivisht dhe me 15.06.2011 në bashkëpunim me stafin komunal. Kontraktori ka ristartuar me punë. Është ndërtuar bazamenti për shtyllë si dhe është instaluar fusha hyrëse 10kV. Punët tjera të parapara me specifikim teknik janë në vazhdimësi.Nëse nuk do të paraqiten probleme tjera pritet që projekti të përfundojë në fund të Korrikut.	Duhet të informohen përfaqësuesit e AREVA të jenë prezent për testimin e bartjes së të dhënave nga SS Skenderaj në Qendrën Komanduese.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 21 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

3	<p><i>Sbërbime Konsulentësh për Paket Projektin NS 400/110 kV – Ferizaj 2 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 & 110 kV</i></p>	700,000.00 €	ECLO	668,500.00 €	17.12.2009	17.10.2011	INGEDIA (Ro)	0.00 €	<p>(i.)Gjatë kësaj periudhe raportuese konsulenca e angazhuar Ingedia nga Komisioni Evropian (ECLO), ka zhvilluar aktivitete në komentimin/aprovimin e dizajneve bazike për të dy LOT-at (për nënstacionin NS Ferizaj 2 si dhe për Linjat LP 400 & 110 kV), konform kushteve të kontratës. Së bashku me stafin e KOSTT ka marrë pjesë në FAT në Zagreb për inspektimin e Atransformatorit për TS Ferizaji .Është angazhuar më shumë në përcjelljen e punëve në terren në LOT1 pasi që intenziteti i punëve është më i madh në këtë LOT . Ka organizu takimet interne si dhe ato javore -mujore. Inspektimet në terren kanë qenë sipas planifikimit dhe gjithnjë është raportuar mbi mbarëvajtjen e punëve.Zëvendësimi i liderit të ekipit ende nuk është realizuar</p>	<p>Kërkohet nga ECLO që sa më shpejtë të kryen procedurat e aprovimit të satfit ndërkombëtar të kompanisë konsulente Ingadia</p>
4	<p><i>Paket Projekti Ferizaj-2 <u>LOT-1</u>: NS 400/110 kV Ferizaj 2</i></p>	15,800,000.00 €	BKK	13,656,000.00 €	24.12.2009	23.10.2012	SIEMENS (At)	0.00 €	<p>(i.)Pas aprovimit të dizajneve është vazhduar me punët ndërtimore në terren . Progresi i punëve po shkon me ritëm të mirë, është ndërtuar rrethoja rreth 70%, zyra e terrenit, muret mbrojtës në mes të niveleve. Bazamentet e pajisjeve të TL 110kV kanë përfunduar me strukturat metalike ,janë ndërtuar bazamentet me struktura metalike të pajisjeve të TL 400kV diku 60%. është filluar me ndërtimin e kanaleve për kabllim ,janë liferuar pajisjet e TL rreth 80%.Në Qershor është mbajtur FAT (testimi në fabrikë) në Konçar i TR 300MVA, pritet liferimi i TR. Është mbajtur FAT për Mbrojtje rele dhe komandim .Në përmbledhje diku 60% e punëve në LOT 1 kanë përfunduar . Janë zhvilluar aktivitete edhe në mbajtjen e Mbledhjeve të Progresit Mujor , Komitetit Drejtues, mbledhjet javore të terrenit etj. Është nënshkruar Adendumi Nr.3 i cili ka të bëjë me ndryshimin e dizajnit për riaranzhimin e fushave 110kV, dhe sistemit të kanalizimit.Për shkaqe objektive ka ardhur deri tek zëvendësimi i PM të KOSTT-it</p>	

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 22 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

	<i>Paket Projekti Ferizaj-2 <u>LOT-2</u>:LP ndërlidhëse 400 & 110 kV</i>	7,500,000.00 €	ECLO	6,105,000.00 €	31.12.2009	30.10.2011	UMEL (B&H)	0.00 €	<p>(i.) Është përfunduar me instalimin e OPGW në linjën 400 kV Kosove B - Ferizaj 2 - Shkup si dhe pjesa e konstrukcionit metalik dhe shtrirja e përcuesit në pjesën 110 kV. Realizimi I projekti është sipas planit dinamik që është shumë pozitive. Gjatë kësaj kohe janë zhvilluar aktivitete në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e punëve implementuese. Është bërë shpronësimi i tokave për linjat 400kV dhe 110kV me Bibaj si dhe është në proces shpronësimi i tokave për linjën 110kV NS. Ferizaj 2 - NS. Gjilani 5.</p> <p>(ii) Ka pasë probleme rreth shpronësimit të tokave në komunën e Vitis, por në bashkëpunim me strukturat komunale këto probleme janë zgjidhur. Në linjën 110kV Ferizaj2 - Gjilan5 është punuar deri tek shtylla nr 66 ,por është paraqitur problemi i trases së kësaj linje që takohet me një pikë me linjën Gjilan 5 -Viti e cila është pjesë e projektit NS Gjilani 5 të cilën e udhëheqë KEK. Janë mbajtur takime të përbashkëta për të arritur një kompromis. Të dy palët kontraktuese duhet të sjellin elaboratin teknik për arritjen e zgjedhjes teknike dhe në bashkëpunim me strukturat komunale te Gjilanit të gjejnë zgjidhje.</p>	Në bashkëpunim me strukturat komunale të Gjilanit ,përgjegjëse për caktimin e trases dhe bazuar në propozimet nga ana e kontraktorëve të gjendet zgjidhja e përbashkët e cila kishte me qenë më pak ngarkuese për të dy palët kontraktuese .Duhet të ridizajnohet traseja sipas sygjërimeve të strukturave komunale të cilat propozojnë edhe zgjedhjen më të lehtë dhe më të mirë rreth shpronësimit të tokave
5	<i>Sbërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërtimit të LP 400kV, Kosovë - Shqipëri</i>	1,200,000.00 €	Kfw	1,154,620.00 €	24.09.2009	23.05.2010	INTEC (D)	0.00 €	<p>(i.) Gjatë kësaj periudhës tremujorshe është realizuar faza e evaluimit ,por ende nuk është ardhur deri në përzgjedhjen e ofertuesit</p>	

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 23 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

6	<i>Shtërbime Konsulentësh për Projektin SCADA/EMS & Telekomi</i>	891,541.00 €	BKK	891,541.00 €	15.01.2008	30.10.2010	KEMA (D)	0.00 €	<p>(i.) Stafit i konsulencës së angazhuar (stafi lokal dhe ndërkombtare), ka zhvilluar aktivitete në aprovimin e dizajnit detal për LOT1 si dhe LOT2, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e punëve instaluese duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në testimet "pikë-pikë"(End to End)të pajisjeve të instaluara, ka marrë pjesë aktive në takimet e rregullta javore dhe mujore si dhe ka përgaditur minutat e takimit . Për inspektimet e rregullt që ka zhvilluar ka dorëzuar raportet e inspektimit. Në fund të qershorit ashtu siqë është paraparë me plan dinamik te punëve ka përfunduar Projekti SCADA/EMS & Telekomi, me të ka përfunduar edhe puna e shërbimeve konsulente.</p>	
7	<i>Paket Projekti SCADA/EMS & Telekomi LOT- 1:SCADA/EMS</i>	8,500,000.00 €	BKK	7,875,370.00 €	31.12.2008	30.10.2010	Areva/Komtel (F/KS)	0.00 €	<p>(i.) Sipas planit dinamik projekti ka përfunduar me 30.06.2011.Gjatë periudhës tremujorshe janë realizuar te gjitha punët implementuese të RTU-ve nëpër nënstacione të ndryshme, janë evituar mos funksionimet eventuale të pajisjeve të TL nga ana e KOSTT-it, si parakusht për operimin funksional dhe të qëndrueshëm të SCADA/EMS.Janë zhvilluar "End-To-End" Testimet për SCS ekzistues si dhe Pre-SAT dhe SAT(me vërejtje përkatëse) për RTU. Në NS janë mbajtur takimet e Progresit dhe Komitetit Drejtues. Pas të gjitha testeve të realizuara me 30.06.2011 projekti ka përfunduar dhe komisionimi intern i KOSTT-it ka filluar punën .</p> <p>(ii.) Është nënshkruar deklarata (PAC) e ALSTOM&KOMTEL për përfundimin e punimeve të projektit.Projekti është në fazën garantuese njevjeçare.</p>	Të gjitha vërejtjet e paraqitura gjatë SAT -testimeve dhe vërejtjet që do të paraqiten nga komisioni intern duhet të eliminohen brenda afatit garantues.

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 24 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektor: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

	<i>Paket Projekti SCADA/EMS & Telekomi LOT-2: Telekomi</i>	9,500,000.00 €	BKK	9,214,760.00 €	31.12.2008	30.10.2010	Enegroinvest/Areva (B&H/F)	0.00 €	<p>(i.) Gjatë kësaj periudhë është vazhduar me komentimin/aprovimin e dizajneve detale për sistemin e Telekomit nga konsulenca e angazhuar KEMA dhe ekipi menaxhues i projektit. Është mbajtur mbledhja e fundite Progresit. Është vazhduar me "end-to-end" testet të cilat kanë përfunduar në përgjithësi me sukses në afatin e paraparë. Është nënshkruar dokumenti "Statement of Completion" deklarata mbi përfundimin e punëve së bashku me "listën e vërejtjeve".</p> <p>(ii.) Problemi i shpronësimit në Skenderaj po e pengon mbylljen e linkut optik. Projekti ka përfunduar me 30.06.2011 dhe ka startuar afati garantues njëvjeçar.</p>	<p>Të gjitha vërejtjet e paraqitura gjatë SAT -testimeve dhe vërejtjet që do të paraqiten nga komisioni intern duhet të eliminohen brenda afatit garantues. Kërkohej nga stafi menaxhues i projektit të NS Skenderaj që në rast se vije deri te përfundimi i linkut optik në Skenderaj, të njohtohet 10 ditë përpara ashtu që të sigurohet ekipin e AREVA për testimin e pajisjeve të telekomit NS Skenderaj-Qendra kontrolluese. .</p>
8	<i>LOT 1 - Furnizimi, Instalimi dhe Komisionimi i ATR3 150 MVA në NS. Prishtina 4</i>	3,500,000.00 €	KOSTT	2,214,154.00 €	16.06.2009	15.04.2010	BPetrol & Electroputere (KS/Ro)	0.00 €	<p>(i.) Gjatë kuartalit të dytë nuk është paraqitur ndonjë problem, projekti është nën afat garantues deri më 29.08.2011.</p>	
	<i>LOT 2 - Furnizimi, Instalimi dhe Komisionimi i Pajis. TL në NS. Prishtina 4</i>	800,000.00 €	KOSTT	775,202.37 €	24.07.2009	23.02.2010	SIEMENS (At)	0.00 €	<p>(i.) Projekti është nën afat garantues deri më 30.08.2011. Është punuar në eliminimin e vërejtjeve.</p>	

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 25 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

9	Shërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërrimit të Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 & Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1) dhe TI për Operatorin e Tregut (LOT2)	13,000,000.00€ (LOT1&2)	ECLO	634,000.00 €	05.10.2010	11.072012	INGEDIA (Ro)	0.00 €	<p>(i.) Ekipi i konsulencës ka filluar me mbikëqyrjen e implementimit të Projektit. Për momentin janë të angazhuar në komentimin/aprovimin e dokumenteve fillestare të projektit pasi që ende nuk kanë filluar aktivitetet në terren si dhe kanë organizuar takimin e parë (kick-off) me kontraktuesit. Konsulenca ka dërguar format standarde të dokumenteve të nevojshme për dizajn të projektit, po ashtu ka bërë edhe pranimin e dokumenteve fillestare nga Kontraktuesit. Si dhe ka kompletuar organogramin me staf.</p>	<p>Është mbajtur edhe një takim i veçant ku iu është rekomanduar më nën mënyrë strikte që konsulenca të jetë më vigjente në mbikëqyrjen e implementimit të kontratës</p>
10	Ndërrimit të Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 & Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1)	13,000,000.00 €	ECLO	6,308,920.00 €	10.01.2011	09.07.2012	KONCAR (CRO)	0.00 €	<p>(i.)Projekti është ende në fazën e aprovimit të dokumenteve fillestare, janë aprovuar disa dokumente si, metodologjia e punëve, Ndwrprerwsit dhe Ndarwsit, etj. (ii) është mbetur diskutabile çështja e furnizimit të motorëve për ndarësit, mbetet që kjo çështje të diskutohet me kontraktuesin.</p>	<p>Në mënyrë strikte nga KOSTT është sugjeruar që të angazhohen vetëm nënkontraktues profesional dhe me eksperience pasi që natyra e punëve është shumë specifike dhe nën tension. KOSTT ka njoftuar se nuk mbanë përgjegjësi në rast të aksidenteve nga pakujdesia e kontraktuesit apo nënkontraktuesve..</p>

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 26 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

11	<i>TI për Operatorin e Tregut (LOT2)</i>			834,287.00 €	10.01.2011	09.01.2012	Siemens (At)	0.00 €	<p>(i.) Gjatë muajit Prill është organizuar vizitë për të inspektuar një sistem të ngjashëm i cili është instaluar nga kontraktuesi Siemens në qendrën nacionale dispeçerike të Austrisë APG si dhe në qendrën për barazim tregu APCS. Janë zhvilluar aktivitete edhe në sigurimin e të dhënave teknike me qëllim të krijimit të ndërlydhjeve (interface-ve) ndërmjet sistemit të IT-së për OT dhe sistemeve tjera të SCADA/EMS, Sistemit të kontabilitetit dhe atij të institutit hidrometeorologjik. Nga ana e KOSTT-it janë dërguar letrat zyrtare tek kontraktuesit dhe instituti dhe jemi në pritje të përgjigjeve. (i) Është dërguar specifikimi teknik për aprovim, dhe nga ana e KOSTT janë dërguar komentet, janë mbajtur takime me kontraktuesit e projekteve tjera si SCADA/EMS dhe Sistemit financiar për të analizuar interface-at me sistemet e tyre.</p>	Të mirren parasysh të gjitha sygjërimet që vijn nga ana e ekspertëve të KOSTT
12	<i>Ndërrimi i Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Kosova B ana 400 kV</i>	1.550.000.00 €	KOSTT	1.275.280.00 €	03.08.2010	02.08.2011	Siemens-Monting	881,819.62 €	<p>(i.) Edhe gjatë kësaj periudhe është punuar në fushat në anë 400 kV , në LP 420, AT1, fushën ndihmëse lidhëse, konform kushteve të kontratës (punët ndërtimore , ngjyrosja e strukturave metalike , instalimi i pajisjeve, etj). Janë mbajtur testimet në vend dhe komisionimet . Takimet e rregullta javore dhe mujore janë mbajtur, ku janë përgaditur edhe Minutat e takimit .</p>	Të respektohet plani i çkyçjeve i paraparë

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 27 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

13	<i>Ndërrimi i përçuesit izolatorëve dhe paisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3</i>	2,389,000.00 €	KOSTT	1,959,800.80€	01.06.2011	20.12.2011	ELSA&UKAB	293,970.12 €	(i). Më datën 29.06.2011 është mbajtur takimi i parë . Në takimin e parë janë përcaktuar kërkesat nga ana e KOSTT për kompanin ELSA&UKAB. Është kërkuar që të sjellet i gjithë dokumentacioni e nevojshëm para fillimit të ekzekutimit të punëve	Që dokumentacioni i kërkuar të jetë plotësisht sipas kërkesave të KOSTT-it
14	<i>Kycja e NS Lipjanit në linjën LP 212 (KOS A - Ferizaj)</i>	1,050,000.00 €	KOSTT	1,397,094.32 €	27.06.2011	27.07.2012	UMEL (B&H)	209,564.21 €	(i). Më datën 16.06.2011 është mbajtur takimi i parë .Në takimin e parë janë përcaktuar kërkesat nga ana e KOSTT për kompanin UMEL DALEKOVOD MONTAZHA. Është kërkuar që të sjellet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm para fillimit të ekzekutimit të punëve	Që dokumentacioni i kërkuar të jetë plotësisht sipas kërkesave të KOSTT-it
14	<i>Ndërrimi i Mbrojtjeve Rele në NS 110/35kV Prishtina 2 dhe Prishtina 3</i>	250,000.00 €	KOSTT	168,880.32 €			KONCAR (KET)		(i). Eshtë nënshkruar kontrata, pritet të mbahet takimi fillestar me kontraktorin dhe definimi i kërkesave sipas planit të menaxhimit të projektit	

	RAPORT TREMUJOR	DT-PB-002
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 28 nga 46</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

